



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:229781
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05412011

CN.nr.248/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen juridike të paditëses V.M., nga Gjilani, Rr. “A..... A.....”, nr.7, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.B., avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensim i kualifikimit në punë, duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës, i paraqitur nga e autorizuar e paditëses, kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1365/21 të datës 21.12.2022, me datën 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

LEJOHET përsëritja e procedurës sipas propozimit të ushtruar nga e autorizuar e paditëses V.M., nga Gjilani, dhe ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1365/2021 i datës 21.12.2022, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të përsëritjes.

A r s y e t i m

Paditësja V.M., nga Gjilani, nëpërmes të autorizuarës avokate V.B., nga Gjilani, ka parashtruar propozim për përsëritjen e procedurës e cila ka përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.1365/21 të datës 21.12.2022, i plotfuqishëm nga data 03.02.2023, propozimin e ka bazuar në nenin 232, pika g) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Në propozim ka theksuar se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e plotfuqishëm e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses duke arsyetuar sepse kërkesa e paditëses nuk gjen mbështetje ligjore në kontratën kolektive të arsimit. Pala paditëse, në propozim pretendon se refuzimi i padisë është vendim diskriminues ndaj paditëses pasi që e njëjta gjykatë, në të njëjtën periudhë kohore dhe më vonë për të njëjtën çështje juridike civile ndaj palëve të tjera ndërgjyqës ka

vendosur në mënyrë meritore duke e aprovuar padinë dhe kërkesëpadinë. Tutje, në propozim për përsëritje të procedurës pala paditëse thekson se me datën 9 tetor 2023, Gjykata Supreme e Kosovës ka dal me mendim juridik lidhur me këto çështje se kompensimi i mësimdhënësve mbi bazën e licencimit duhet të trajtohet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me vendimin e qeverisi i cili ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023 dhe se e paditura në këtë rast ka obligim që paditëses t'ia paguaj diferencën e pagës në bazë të licencimit sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008, andaj meqë kemi rrethanë të re-Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 09 tetor 2023, janë plotësuar kushtet për lejimin e përsëritjes së procedurës ashtu që të aprovohet propozimi dhe të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan, C.nr.1365/21 i datës 21.12.2022, të lejohet përsëritja e procedurës dhe dosja e lëndës t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të përsëritur.

Propozimi për përsëritje të procedurës i është dërguar palës së paditur mirëpo e njëjta nuk ka dhënë përgjigje në propozim.

Gjykatësja individuale e Gjykatës së Apelit të Kosovës, bëri shqyrtimin e shkresave të lëndës në pajtim me dispozitat e nenit 239 par.1 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të thënieve dhe shkaqeve të paraqitura në propozim, gjeti se:

-Propozimi është i lejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja nëpërmjet të autorizuarit të saj ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e kualifikimit në punë. Gjykata e shkallës së parë pas paraqitjes së përgjigjes në padi, jashtë seancën ka marr aktgjykim me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi pretendimet e paditëses të paraqitura në propozimin për përsëritje dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 232 paragrafi 1, pika g) të LPK-së, për lejimin e përsëritjes së procedurës të përfunduar me aktgjykim të formës së prere, ngase kanë ndryshuar rrethanat mbi të cilat gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1365/21 të datës 21.12.2022.

Në kreun e XIV të Ligjit Nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, propozimi për përsëritjen e procedurës është përcaktuar si mjet i dytë i jashtëzakonshëm, me të cilin lejohet përsëritja nën kushtet e përcaktuara në nenin 232 të LPK-së, nën pikën g) *“në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme”*, andaj gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, nga shkresat e lëndës konstatoi se paditëses Vlorë Maliqi, i është mohuar e drejta lidhur me kompensimin e kualifikimit në punë, ndërsa me krijimin e rrethanës së re përkatësisht provave të reja siç është Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 9 tetor 2023, në të cilin përcaktohet se e çështja e kompensimit të mësimdhënësve mbi bazën e kualifikimit duhet vendosur sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008, si dhe Kontratës Kolektive, duke marr parasysh karakterin detyrues. Mbi këtë bazë

propozimi për përsëritjen e procedurës i ushtruar nga paditësja ka bazë ligjore, andaj duke vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 240 par.2 të LPK-së, vendosi që ta anuloj aktgjykimin C.nr.1365/21 të datës 21.12.2022, i cili është bërë i formës së prerë dhe që çështja t'i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, në përsëritje të procedurës me ç'rast është e obliguar që të caktoj seancë përgatitore, t'i thërret palët ndërgjyqës në mënyrë të rregullt, të administroj provat që gjenden në shkresa të lëndës dhe pas kësaj të nxjerr vendim të rregullt dhe të drejtë duke iu përmbajtur kushteve ligjore për formën dhe përmbajtjen e tij.

Gjykata e Apelit shqyrtoi edhe afatshmërinë e propozimit për përsëritje të procedurës, të paraparë me nenin 234 par.3 të LPK-së, mirëpo konsideroi se në rastin konkret vlen paragrafi 3, me të cilin parashihet se: *'Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet, përveç kur përsëritja kërkohet nga shkaqet e përmendura në nenin 232 par.1 pika a) dhe b) të këtij ligji''*.

Gjykata e Apelit konform nenit 239 paragrafi 1, lidhur me nenin 240 paragrafi 2, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke lejuar përsëritjen e procedurës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CN.nr.248/2023, me datë 05.03.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti

Këshilla juridike:
Kundër këtij aktvendimi, nuk është e
lejuar ankesa neni 240, paragrafi 3 i LPK-së.